

STATUT E AKTHEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE  
"BIOMOLLA SH.P.K"



Në Bilisht, sot më datë 13/01/2017, në respektim të kërkesave të ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, u hartua statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me ortakë themelues:

- **Z. MILAN KRAL**, shtetas Cek, i biri i Frantisek, lindur më 20/12/1968 në Republikën Ceke, dhe banues në Republikën. Ceke, identifikuar nëpërmjet pasaportes Nr. 40893863, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Z. ANDI BECOLLI**, shtetas Shqiptar, i biri i Valentit, lindur më 09/09/1990 në Republikën e Shqipërisë, dhe banues në Korce, identifikuar nëpërmjet pasaportes Nr. BC3567174, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Te cilet hartojne këtë statut të shoqërisë "**BIOMOLLA SH.P.K.**", mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

**KREU I :**

**THEMELIMI - EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA**

**NENI 1**  
**Themelimi**

Shoqëria "BIOMOLLA SH.P.K" është një shoqëri tregtare, e themeluar nga 2 ortakë të shoqërisë, te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**NENI 2**  
**Emertimi**

Shoqëria tregtare është vendase dhe emërtohet "**BIOMOLLA SHPK**" Korce emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 3**  
**Objekti**

Shoqëria "BIOMOLLA SHPK" Korce ka për objekt;

Import-eksport produktesh bujqesore, industriale, minerale, elektroshtepiake, makineri dhe pajisje, produkte farmaceutike, inpute bujqesore dhe blegtorale etj.

Grumbullim produktesh bujqesore, blegtorale, akuakultures, perpunim i tyre, ruajtje ne ambiente frigoriferike, paketim dhe amballazhim te produkteve te zinxhirit bujqesor. Kultivim i produkteve bujqesore, prodhim fidane. Afrim teknologjie bujqesore dhe blegtorale, industriale.

Tregtim makineri dhe linja teknologjie te te gjitha fushave apo veprimtarive ekonomike si bujqesi, industri e lehte apo e rende etj.

Investime dhe menaxhim ne turizem, hoteli, resorte, bar, restorante.

Agjenci dhe aktivitet imobilare te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.

Studime, projektme, financime, ndertim dhe menaxhim te objekteve ekonomike, social-kulturore, industrial, shtepi banimi, rruge, ura, kanalizime, parqe industriale etj.

Asistence teknike konsultative ne fushat ekonomike, juridike, inxhinierike.

#### **NENI 4 Selia**

Selia e shoqerise "BIOMOLLA SHPK" Korce eshte ne adresen: "Lagjja Nr.3, Pallati 29, Superstrada Devoll, Bilisht-Korce".

#### **NENI 5 Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "BIOMOLLA SHPK" Korce eshte e pakufizuar.

#### **KREU II KAPITALI**

#### **NENI 6 Kapitali Themeltar**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 Leke (njqind mije). Kontributi ne kapitalin themeltar te shoqerise perbehet nga 2 kuota, me vlere nominale 100.000 Leke, i depozituar sipas ligjit dhe i ndare dhe zoteruar nga:

- a) Ortaku **Milan KRAL**, i cili zoteron 1 (nje) kuote me vlerë nominale 80,000 lekë.
- b) Ortaku **Andi BECOLLI**, i cili zoteron 1 (nje) kuote me vlerë nominale 20,000 lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të

paluajtshme apo të drejta).

## NENI 7 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## NENI 8 Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shit - blerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

## NENI 9





Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Statuti dhe Akti Themelimi të saj.



### **KREU III: KUSHTET EKONOMIKE**

#### **NENI 10**

Shoqëria cel llogarë bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj. Ortaket dhe administratorët e saj, depoziton faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është celur llogaria .

#### **NENI 11**

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaket kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo teresisht kontributet e tyre e përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë vendimet e asamblese së ortakeve të shoqërisë duhet të merren paraprakisht me shkrim. Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u behen të ditura.

#### **NENI 12**

Me vendim të ortakeve të shoqërisë, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

#### **NENI 13**

Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose disa ortake të tjera, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

### **KREU IV:**

### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE**

#### **NENI 14 Personaliteti Juridik**

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në QKR, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të kësaj qendre. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe paisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatim Taksave Tirane.



## NENI 15 Asambleja e Ortakeve

Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji ne fuqi. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

## NENI 16

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit të Themelimi dhe Statutit të saj dhe normat e se drejtes tregtare nderkombetare.

## NENI 17

### Te drejtat dhe detyrat e Asamblese

Asambleja e Ortakeve e shoqerise ka dhe keto të drejta dhe detyra kryesore:

- Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Të kerkoje dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe kane të bjene me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo per cdo llogari të celur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese. Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tij.
- Të kryeje sherbime per realizimin e objektivave dhe qellimeve të veprimtarise se rregullt ligjore të Shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon ne cdo kohe Administratoret e shoqerise, cakton ekspertin kontabel të autorizuar. Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon per pregatitjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ekonomiko financiar të aktivitetit të shoqerise, të cilin ia paraqesin ortakeve mbi bazen e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortaket kane të drejten e miratimit vendimor të ketij bilanci.
- Miratimi i bilancit financiar vjetor mbi bazen e të dhenave të kontabilitetit, qe behet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Ortakeve kryesisht si dhe Administratoret, ushtrojne dhe keto të drejta per te mundesuar per të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane të domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarise tregtare të shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave të saj sic mund të jene :

- Të lidhin kontrata të ndryshme qe kane per objekt blerjen, shitjen, kembimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme ( të luajtshme apo të paluajtshme ), si me persona fizik dhe ata juridike, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe ne rast të blerjes se pasurive të paluajtshme, të bejne dhe transkriptimin e pronesise se saj ne

favorin e tyre ne Hipoteken e ZRPP, per të dokumentuar nje rrethane të tille dhe si shtese të kapitalit ne natyre.

- Të kryeje cdo lloj veprimi prane të gjitha zyrave private dhe shtetere, Bankat e cdo niveli etj. qe kane të bejne me Garancite, sipermarrjet, marrjen e kredive, siguracioneve, transportit brenda dhe jashte shtetit ), per zhdoganimin e mallrave të importuara apo eksportuara, ate të plotesimit me korektese të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes ne kohe të cdo detyrimi. Ne rastet kur keto veprime juridike kryhen nga administratori i emeruar nga ortaku i vetem ose personi qe e perfaqeson ate mbi bazen e prokures, keta ne perfundim të realizimit të veprimit perkates detyrohen qe të njoftojne menjehere dhe t'i japin llogari ortakut te vetem.
- Administratoret ose perfaqesuesi me prokure jane individualisht pergjegjes ndaj shoqerise apo të treteve, per veprime të kryera ne shkelje të ligjeve dhe qe bien ne kundershtrim me kete Statut dhe per demin e shkaktuar me faj, sipas rastit, Ortaket mund të ngrejne dhe të kerkojne ndaj tyre padi per shlyerjen e demit civil, duke perfshire dhe të drejten per të bere kallezim per ndjekje penale ne Prokurorine e juridiksionit tokesor ku ka seline shoqeria.

### NENI 18 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### NENI 19 Administrimi

Administratoret e shoqerise "BIOMOLLA SHPK", jane si me poshte:

1. Daniel KRAL, me pashaporte me Nr. 41245654 me afat 5- vjecar.
2. Andi BECOLLI, me pashaporte me Nr BC3567174 me afat 5-vjecar.

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane cetur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.



Njesite e tjera strukturore të shoqërisë si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



## NENI 20 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Te aplikoje per grante vendore dhe te huaja qe mbeshtesin zhvillimin e biznesit te shoqerise BIOMOLLA SHPK.
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatim Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose egziston risku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 21

Asambleja e Ortakeve dhe administratoret e shoqërisë, kanë të drejte që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, duke lidhur kontrate sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Ri të Punës në fuqi dhe me ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore" të ndryshuar si dhe në përputhje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vete punëdhësi.

## KREU V

### BILANCI, TË ARDHURAT E SHOQËRISE

## NENI 22 Viti Financiar

Veprimet ekonomiko financiare të shoqërisë, mbyllen me datën 31 Dhjetor të cdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqërisë, mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve një ekspert kontabel i autorizuar.

**Eksperti** ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakes të vetme. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakes së vetme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

## NENI 23

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga cdo subjekt privat, që ushtron veprimtari tregtare.

## NENI 24 Bilanci Vjetor





**Bilanci Kontabel vjetor**, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortakut, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

#### NENI 25

**Të ardhurat neto ( Dividenti )** qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbësin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

#### KREU VI

#### Prishja- riorganizimi i shoqerisë

#### NENI 26

#### Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- f) dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, ligjit.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji.

## NENI 27

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata vepronë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/ëve.

## NENI 28

### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët

e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### **NENI 29** **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### **NENI 30** **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### **NENI 31** **Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
  - a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.





**NENI 32**  
**Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

**NENI 33**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 34**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**NENI 35**  
**Dispozita përfundimtare**


Ky statut u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare "BIOMOLLA SH.P.K. nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKET THEMEËLUES TE SHOQERISE "BIOMOLLA SH.P.K"**

**MILAN KRAL**

  
Milan Kral

**ANDI BECOLLI**

  
ANDI BECOLLI



**STATUTE AND FOUNDATION ACT  
OF THE COMMERCIAL COMPANY  
"BIOMOLLA SHPK" KORCE**

In Bilisht, today on 13.01.2017, in respect of the requirements of Law 9901 dated 14.04.2008, "On traders and commercial companies" was compiled the Statute of the company with limited liability with the founding shareholders:

- Mr. MILAN KRAL, Czech citizen, son of Frantisek, born on 20/12/1968, in the Czech Republic, and resident in the Czech Republic, identified by the passport no. 40893863, major, with full legal capacity to act.

- Mr. ANDI BECOLLI, Albanian citizen, son of Valent born on 09.09.1990, in the Republic of Albania, and resident in Korce, identified by the passport no. BC3567174, major, with full legal capacity to act.

Who compiled the Statute of the company "BIOMOLLA SH.PK" based on Law 9901 dated 14.04.2008, "On traders and commercial companies", Law 9723 dated 03.05.2007 "On National Registration Centre", the Customs Code, Fiscal tax, as follows:

**Chapter 1  
ESTABLISHMENT-NAME-OBJECT-HEADQUARTER-DURATION**

**Article 1  
ESTABLISHMENT**

"BIOMOLLA Sh.p.k., is a commercial company, founded by two shareholders, who are responsible for the obligations of the company and personally cover losses only up to the outstanding contribution agreements.

**Article 2  
NAME**

The commercial company is named BIOMOLLA SHPK, a name that shall be stamped even in its seal.

**Article 3  
OBJECT**

Import-export agricultural products, industrial minerals, electrical appliances, machinery and equipment, pharmaceutical products, agricultural inputs and livestock, etc.

Collection of agricultural products, livestock, aquaculture, processing of their storage environments refrigeration, packing of agricultural products. Cultivation of agricultural products, seedlings production.

Bringing agricultural, industrial and livestock technology.

Machinery and technology trade lines to all areas or economic activities as agriculture, light industry or serious etc.

Investment and tourism management, hotel, resort, bar, restaurants.

Real estate agency.

